

# “Të rinjtë nga mjediset rurale për integrim të Maqedonisë në BE”



## Donator:

Bashkimi Evropian (EuropeAid/138660/ID/ACT/MK)

## Partnerë në projektin:



## Informacione për kontakt

**CNVP – Dega në Republikën e Maqedonisë,**  
rr. Mirka Ginova, Nr. 13, 1000 Shkup;  
Tel: 02 3217 322; email:  
saso.petrovski@cnvp-eu.org

**Rrjet për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë,**  
rr. “Kosta Velinov” Nr. 3a,  
1000 Shkup; Tel: 02 3075 506;  
email: info@ruralnet.mk  
www.ruralnet.mk  
FB: www.facebook.com/  
RuralDevelopmentNetwork

# Punëtori për edukim për bashkëmoshatarët



Gjatë muajve të korrikut, gushtit dhe nëntorit 2018, në kuadër të aktivitetit 1.3 të projektit Të Rinjtë nga Mjediset Rurale për Integrim të Maqedonisë në BE janë zhvilluar 5 punëtori për edukim të bashkëmoshatarëve me anë të cilave janë përhapur njohuritë e përfituara të të rinjve trajnuar nga trajnimi për trajnues që u zhvillua në qershor 2018. Përveç transferimit të njohurive të përfituara, trajnuesit e rinj kanë praktikuar aftësi të prezantimit për edukim të drejtpërdrejtë dhe diskutim paneli me të rinjtë e rajoneve të tyre. Të gjitha këto mbledhje ishin udhëhequr



me mentorimin e një eksperti për fasilitim dhe koordinim.

Punëtoritë janë zhvilluar në Shtip, Pehçevë, Dellçevë, Strumicë dhe Kopan dhe kanë marrë pjesë nga 25 perona të rinj të rajonit. Pjesëmarrësit u njoftuan me bazat e Bashkimit Evropian dhe më tepër aspekte të procesit të aderimit të cilat janë me rëndësi për personat e rinj.

Punëtoritë kanë kontribuar për informim më të mirë të të rinjve për motivimin e tyre dhe përforcimin e vetëdijes dhe për nevojën dhe fuqinë e kontribuimit aktiv të të rinjve për një integrim evropian të suksesshëm të Republikës së Maqedonisë.

Gjatë punëtorive pjesëmarrësit ishin të ndarë në grupe të vogla me detyrë që të japin mendime dhe rekomandime për mënyrat e pjesëmarrjes së të rinjve në shoqërinë dhe rekomandime lidhur me integrimin e Maqedonisë në BE pa kufizim për cilën kanë të bëjnë. Secili grup me anë të përfaqësuesit ka pasur detyrë të prezantojë punën në grupe dhe të merr pjesë në diskutim.

Rekomandimet që kanë dhënë të rinjtë kanë përfshirë më tepër aktorë në rrethinën e tyre, ndërsa mund të përmendën shkollat, politikanët në nivelin kombëtar, mediet, autoritet lokale dhe tjera të cilëve ju ishin rekomanduar se çfarë kanë nevojë të rinjtë:

- Mobilitet, programe, kurse – më tepër informacione
- Interesim më të madh për programet e shkëmbimit të të rinjve
- Organizim i punës vullnetare
- Pjesëmarrje në arsimin joformal – PR edukime, punëtori
- Aktivizim të këshillave rinore (themelimi i më tepër organizatave rinore)
- Rritje të bashkëpunimit me organizatat rinore të BE-së
- Zhvillimi i më tepër punësorive edukative
- Themelimi i klubit për të rinj në secilën komunë
- Prezantimi i më tepërt i punës praktike në arsim
- Përfshirje në ndërmarrje të vogla dhe të mesme, përgatitje për tregun e punës
- Njohje të gjitha diplomave tona me hyrje në BE
- Ndryshim të sistemit të funksionimit të partive politike
- Përfshirje të të rinjve në miratimin e ligjeve
- Përfshirje në debate me politikanë



- Iniciativë për përmirësim të infrastrukturës lokale
- Veprim në drejtim të rritjes së vetëdijes ekologjike tek qytetarët
- Të prezantohen masa më të rrepta dhe më rigorozet për politikanët që keqpërdorin pozitën e tyre
- Ulje të diskriminimit gjinor
- Liri të të folurit publik (medie)

# Punëtori informative për përfshirje sociale

Gjatë muajit të tetorit 2018, me anë të projektit “Të Rinjtë nga Mjediset Rurale për Integrim të Maqedonisë në BE» janë zhvilluar 5 punëtori në shkollat e mesme të Rajonit Lindor dhe Juglindor edhe atë në Shtip, Radovich, Strumicë, Berovë dhe Gjevgjeli. Grupet e synimit ishin nxënësit e vitit të katërt dhe të rinj tjerë të interesuar që ishin të informuar me anë të organizatave partnere lokale. Punëtoritë kanë përfshirë moderator të Këshillit Rinor të Maqedonisë i cili me anë të veglave përkatëse ka edukuar të rinjtë për përfshirje sociale, politika rinore, programe aktuale vendore dhe të BE të synuar për të rinjtë në Maqedoni, mundësitë për punësim dhe informacione tjera për aktivizëm rinor. Pjesëmarrësit kanë pasur mundësi që për gjitha institucionet relevante siç janë qeveria, komuna, shkolla, prindërit dhe aktorë tjerë të përpilojnë mesazhe të shkurta me sugjerime për përmirësim të ndonjë aspekti të jetës së tyre dhe përditshmërisë. Në organizimin e ngjarjeve kanë marrë pjesë organizata lokale partnere të projektit, drejtorët dhe mësuesit e shkollave.

Me këto ngjarje, vetëm në tetor, drejtpërdrejtë kanë qenë të përfshirë 223 persona të rinj. Nga këto ngjarje ishte përgatitur infografik që ka përmbledhur konkluzionet kryesore të punëtorive.



## МЛАДИТЕ ОД РУРАЛНИТЕ СРЕДИНИ ЗА ИНТЕГРАЦИЈА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА ВО ЕУ


## МЛАДИТЕ ОД РУРАЛНИТЕ СРЕДИНИ ЗА ИНТЕГРАЦИЈА НА РМ ВО ЕУ

200+



### ПРЕПОРАКИ

КРЕИРАНИ ПОВЕЌЕ ОД 200 ПРЕПОРАКИ ОД СТРАНА НА СРЕДНОШКОЛЦИ ВО 5 РАЗЛИЧНИ ОПШТИНИ ВО РМ



### ОПШТИНА - 18 ПРЕПОРАКИ

\* Вклучување на младите во повеќе активности на ниво на општина  
\* Активирање на Локални млади совети

### НЕВРАБОТНОСТ

Само 2 од 50 млади луѓе, знаат од прилика колкава е младинската вработеност, и само 2 од 50 млади луѓе, знаат што претставува Социјална Инклузија

Само 2 од 50



### ВЛАДА НА РМ - 12 ПРЕПОРАКИ

\* Подобрување на културната интеграција и социјалниот живот на младите  
\* Намалување на невработеноста и креирање на механизми за намалување на невработеноста



УНИКАТНИ  
ПРЕПОРАКИ

70



КРЕИРАНИ 70 УНИКАТНИ ПРЕПОРАКИ ОД СТРАНА НА СРЕДНОШКОЛЦИТЕ ОД ИНТОЧНИОТ И ЈУГОИСТОЧНИОТ РЕГИОН НА РМ, НАСОЧЕНИ КОН 12 РАЗЛИЧНИ ИНСТИТУЦИИ

12  
МАПИРАНИ  
ИНСТИТУЦИИ


### МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА - 14 ПРЕПОРАКИ

\* Воведување на практична настава во сите образовни институции (општи гимназии, средни стручни)  
\* Вложување во инфраструктурата во училиштата  
\* Подобрување на наставните програми и нивно навремено ажурирање




### МАПИРАНИ ИНСТИТУЦИИ

Младите како најбитни институции кои сметаат дека можат да влијаат кон полесна и подобра интеграција на Република Македонија во ЕУ се Влада на РМ, Министерството за образование и наука и Општините.



### МЛАДИ - 6 ПРЕПОРАКИ

\* Активни членови на општеството  
\* Активно вклучување на сите заинтересирани млади во процесите на носење на одлуки



### СОРАБОТКА

СОРАБОТКА БЕШЕ ОСТВАРЕНА СО 5 УЧИЛИШТА ВО 5 РАЗЛИЧНИ ОПШТИНИ, КАДЕ 224 СРЕДНОШКОЛЦИ КРЕИРАА 250 ПРЕПОРАКИ ЗА ПОЛЕСНА И ПОДОБРА ИНТЕГРАЦИЈА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА ВО ЕУ



### УЧИЛИШТА - 7 ПРЕПОРАКИ

\* Едукативни и креативни предавања  
\* Училишта без дискриминација  
\* Склучување на договори со приватни компании за подобра практична настава



This project is funded by EU

# Vegla për aktivizëm rinor

Gjatë nëntorit dhe dhjetorit 2018, ishte angazhuar një ekspert për përgatitjen e një manuali që do të shërbejë si vegël për aktivizëm rinor. Ky është krijuar që të ndihmojë facilitatorët, trajnuesit dhe ekspertët që punojnë në fushën e aktivizmit rinor, të dizajnojnë dhe të realizojnë program për aktivizëm rinor të të rinjve që janë të interesuar të bëjnë ndryshime në komunitetin e tyre më të ngushtë, komunë, qytet dhe madje shtet. Ky program i krijuar për zbatim të trajnimeve është program për udhëheqje shoqërore që promovon dialogun ndërkulturor dhe përgjegjësitë shoqërore si kompetenca kryesore udhëheqëse.



<http://ruralnet.mk/wp-content/uploads/2018/12/Прирачник-за-младински-активисти-финален.pdf>

## Forume për këshillim karriere

Më 11 dhe 12 dhjetor 2018 në Shtip dhe Strumicë, si aktivitet i projektit “Të Rinjtë nga Mjediset Rurale për Integrim të Maqedonisë në BE» janë zhvilluar takime për këshillim karriere të të rinjve. Në punëtorit kanë marrë pjesë më tepër se 130 të rinj nga rajoni lindor dhe juglindor i planifikimit, si anëtarë të organizatave joqeveritare si dhe nxënës të shkollave të mesme, institucioneve lokale publike dhe tjera. Një ekspert i rrjetit për zhvillim rural të Kroacisë dhe kryetari i rrjetit për zhvillim rural të Serbisë kanë prezantuar shembuj të punësimit, rrjetëzimit dhe informimit të popullatës rurale me anë të projekteve për turizëm rural dhe prodhimtari të ushqimit ku bashkohen mundësitë e njerëzve nga fshatrat fqinj për rritjen e ofertës dhe konkurrencës. Gjithashtu ishin prezantuar përparësitë për aplikantë deri në moshën 40 vjeçe për masat në programin kombëtar për zhvillim rural dhe IPARD programit. Në pjesën e dytë përfaqësues të Këshillit Kombëtar të të Rinjve në Maqedoni (KKRM) kanë prezantuar programin shtetëror për garanci rinor, si dhe shembuj praktik të zbatimit.

Persona të dalluar afarist nga Shtipi, z-nja Valentina Krmova nga “Kontesa Krmovi DOOEL”, z-nja Roska Grkova Stojanova, Spec. Fizioterapet “DOO Fizio-M” nga Radovishi dhe z. Krste Georgiev “Best Fud” dhe Ljupço Eftimov “Eftimov DOOEL” me anë të fjalimeve për motivacion kanë shpjeguar rrëfimin e tyre të suksesshëm, problemet që i kanë pasur me kuadrot e rinj dhe me qëndrimin e gabuar e të rinjve që nuk mund të krijojnë karrierë në Maqedoni. Ata kanë theksuar rëndësinë e praktikës për të rinjtë që të përcaktojnë afnitetet e tyre dhe të vazhdojnë me jetën dhe karrierën në drejtimin e duhur.

Profesorë të shkollave të mesme të rajonit gjatë ngjarjes kanë zhvilluar bashkëpunim me firmat e pranishme për vullnetarizëm dhe mësim praktik të nxënësve. Një përfaqësues i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë ka prezantuar gjitha programet e volitshme për të rinjtë e papunësuar që janë në dispozicion në Maqedoni dhe shembuj pozitiv nga zbatimi i tyre.



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

---

Ky botim është përpiluar me ndihmën e Bashkimit Evropian.  
Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Fondacionit CNVP dhe nuk mund të merret në asnjë mënyrë për të pasqyruar mendimet e Bashkimit Evropian.